



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DREJTORIA E KURRIKULËS DHE KUALIFIKIMIT

Nr. ____ prot.

Tiranë ____ . ____ . 2026

THIRRJE PËR BASHKËPUNËTORË

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar në mbështetje të nenit 58, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 98, datë 27.02.2019, të Kryeministrit, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” (ASCAP), nenit 7 dhe nenet 10-12 të Urdhrit të Ministrit nr. 32, datë 28.01.2020, “Për përcaktimin e metodave të brendshme të punës dhe sjelljes së personelit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, rregullores së brendshme Nr. 492. prot., datë 30.07.2020 “Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm”, **hap thirrjen për bashkëpunëtorë të jashtëm** të cilët do të angazhohen në realizimin e objektivave dhe veprimtarive të planifikuara nga ASCAP.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë me kohë të plotë në një nga degët e mësuesisë.
2. Të kenë të paktën 5 vjet eksperiencë pune në arsimin parauniversitar.
3. Të ketë vlerësimin “Shumë mirë” ose “Shkëlqyeshëm” në kualifikimin përkatës.
4. Të kenë përvojë paraprake në një ose disa nga veprimtaritë e mëposhtme:
 - Zhvillimin dhe zbatimin e kurrikulës në profilin dhe ciklin përkatës;
 - Zhvillimin profesional të mësuesve (përgatitje e materialeve për trajnimin e mësuesve, zhvillim i trajnimeve etj.);
 - Menaxhimin e veprimtarive apo projekteve në institucionin arsimor ku punon;
 - Drejtimin dhe menaxhimin e institucionit arsimor;
 - Mbështetjen e shërbimit psiko-social në institucionin arsimor;
 - Mbështetje të sigurisë së nxënësve në mjedisin arsimor;
 - Sigurimin e gjithëpërfshirjes në institucionin arsimor përmes punës me grupe me nevoja të veçanta;
 - Bashkëpunimin me ASCAP dhe institucione të tjera të varësisë së MAS për realizimin e veprimtarive të tyre në mbështetje të edukimit në arsimin parauniversitar;
 - Etj.
5. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
6. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
7. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Dokumentacioni dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Jetëshkrimi (CV-ja)
2. Fotokopje e diplomës së institucionit të arsimit të lartë
3. Certifikatë kualifikimi (nëse e disponon)
4. Fotokopje të kartës së identitetit ID.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet me postë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me adresë: Rruga Naim Frashëri, Nr.37, Tiranë

Afati i dorëzimit të dokumentacionit deri me 16.01.2026

Faleminderit!